



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref. nr. 02 / 972 Dt. 06 / 06 /2019

Konkurs për rektor të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan

Në bazë të nenit 19, paragrafi 1, të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, Këshilli Drejtues i Universitetit "Kadri Zeka", në mbledhjen e mbajtur më 03.06.2019, mori vendim për shpalljen e konkursit për:

Rektor të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan

Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet si në vijim:

1. Të ketë përvojë të dëshmuar në mësimdhënie akademike, kërkime shkencore dhe të ketë gradën e profesorit të rregullt, profesorit të asociuar ose profesorit asistent.
2. Të ketë përvojë të dëshmuar menaxhuese.

Procedura e përzgjedhjes:

- Konkurrimi për postin e rektorit është i hapur për kandidatët e brendshëm dhe të jashtëm.
- Komisioni profesional i zgjedhur nga Senati ka për detyrë që të verifikojë nëse kandidatët e paraqitur për rektor i plotësojnë kushtet e parapara me konkurs.
- Rektorin e zgjedh Këshilli Drejtues nga lista e kandidatëve të propozuar nga Komisioni profesional.
- Këshilli Drejtues i interviston kandidatët që kanë plotësuar kushtet për konkurrim në këtë post. Në këto intervista, secili kandidat prezanton një vizion gjithëpërfshirës për zhvillimin e strategjisë së ardhshme të Universitetit dhe qasjen e tij menaxhuese.
- Këshilli Drejtues ka të drejtë të refuzojë listën e kandidatëve të propozuar nga Komisioni profesional, duke e arsyetuar atë.
- Rektori zgjidhet me shumicën absolute të votave të anëtarëve të Këshillit Drejtues. Në rast se, asnjë kandidat nuk e fiton këtë shumicë në radhën e parë të votimit, atëherë dy kandidatët me numrin më të madh të votave kualifikohen në votimin e dytë. Nëse, asnjëri nga dy kandidatët nuk e fiton shumicën e votave të

anëtarëve të përgjithshëm tri herë radhazi, procedura e zgjedhjes përsëritet nga fillimi, respektivisht, rishpallet konkursi.

- Për mospranimin e kandidatëve për pozitën e rektorit, për shkak të konfliktit të interesit aplikohen dispozitat e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Kandidatët, së bashku me kërkesën, duhet të paraqesin këto dokumente:

- Biografinë e shkurtër,
- Certifikatën e lindjes,
- Vendimin/certifikatën ekuivalente të titullit akademik,
- Përmbledhjen e përvojës akademike (në mësimdhënie, kërkime shkencore, krijimtari artistike) dhe përvojën menaxheriale,
- Certifikatën nga gjykata, që nuk është nën hetime.

Dokumentet e kompletuara në kopje fizike duhet të dorëzohen çdo ditë pune, prej orës 8.00-16.00 në zyrën e arkivit të Universitetit “Kadri Zeka” dhe duhet t’i adresohen: Komisionit profesional të Senatit të Universitetit.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediet e shkruara dhe në ueb faqen zyrtare të Universitetit www.uni-gjilan.net , përkatësisht nga data 07.06.2019 deri më 21.06.2019, në orën 16.00.